



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

URDHËR EKZEKUTIMI

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,
në Konfirmimin e Prefektit të Qarkut Berat.

Nr. 1966/2 Prot, Datë 09/ 07 / 2018 për marrjen në dorëzim të aktit;

URDHËROJ:

- Të zbatohet vendimi Nr. 72 Datë 27 / 06 / 2018 i Këshillit të Bashkisë.
Bashkëlidhur kenë vendimin.
- Përpiloni dhe lidhni listën e institucioneve, ndërmarrjeve, zyrave që do t’u
adresohet vendimi.
- Ngarkohet** Grupi për Menaxhim Strategjik
- Respektoni afatet kohore dhe ligjore.

KRYETARI I BASHKISË
PETRIT SINAJ



Konc: Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ledina Gjoroveni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

NR 72 Datë 27 / 06 / 2018

Mbi miratimin e Projektit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Berat 2019-2021.

Këshilli i Bashkisë Berat i mbledhur sot në datën 27.06.2018, pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Grupi për Menaxhim Strategjik, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8/2, neni 41, neni 54 /dh ; ligji 68 /2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 36; ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6/1 date 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”,

Vendosi :

- 1.Miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Bashkisë Berat, hartuar sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
- 2.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhim Strategjik.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Nikoleta MANKA



Vendimi u miratua me 23 vota pro
— vota kundër
— vota abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

URDHËR EKZEKUTIMI

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",
në Konfirmimin e Prefektit të Qarkut Berat.

Nr. 1466/2 Prot, Datë 09/07/2018 për marrjen në dorëzim të aktit;

URDHËROJ:

-Të zbatohet vendimi Nr. 73 Datë 27/06/2018 i Këshillit të Bashkisë.
Bashkëlidhur keni vendimin.

-Përpiloni dhe lidhni listën e institucioneve, ndërmarrjeve, zyrave që do t'u
adresohet vendimi.

-Ngarkohet Drejtoria e Financës , Drejtoria e MBNJMP dhe Juridike

-Respektoni afatet kohore dhe ligjore.

KRYETARI I BASHKISË
PETRIT SINAJ



Konc: Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ledina Gjoroveni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

NR 73 Datë 27 / 06 / 2018

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Berat dhe Njësive të Vartësisë për vitin 2017.

Këshilli i Bashkisë Berat i mbledhur sot në datën 27.06.2018, pasi u njoh "Raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Berat dhe njësive vartëse për vitin 2017", mbështetur në ligjin nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 7, neni 8, ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 51,

Vendosi :

1. Miratimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Berat dhe njësive vartëse për vitin 2017, bashkëlidhur këtij vendimi .
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e MBNJMP dhe Juridike , Drejtoria e Financës

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Nikoleta MANKA



Vendimi u miratua me 18 vota pro
- vota kundër
5 vota abstenim